VENDIM
Nr.1077, datë 18.6.2008

PËR KRIJIMIN E FONDIT TË KOMPENSIMIT FIZIK NGA FONDI PYJOR DHE KULLOSOR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të ligjit nr.9235, datë 29.7.2004 "Për kthimin dhe kompensimin e pronës", të ndryshuar, dhe të ligjit nr.8743, datë 22.2.2001 "Për pronat e paluajtshme të shtetit", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Nga fondi shtetëror, pyjor dhe kullosor, në administrim të Ministrisë së Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, sipërfaqja 71 699,3 (shtatëdhjetë e një mijë e gjashtëqind e nëntëdhjetë e nëntë presje tre) ha, kalon në fondin e kompensimit fizik dhe vihet në dispozicion të Agjencisë së Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, sipas lidhjes, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Agjencia e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, pasi bën verifikimin përfundimtar të pronësisë së truallit për fondin e mësipërm, pyje e kullota, e përdor atë për kompensimin e pronarëve, sipas kritereve të përcaktuara në ligj.

3. Pas verifikimit përfundimtar, të bërë nga Agjencia e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, pronat, të cilat rezultojnë me njohje apo kthim pronësie, zbriten nga fondi i mësipërm.

4. Ngarkohen Ministria e Brendshme dhe Agjencia e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

MUNDËSIA PËR FOND KOMPENSIMI NË FOND PYJOR E KULLOSOR

Qarku	**Rrethi**	**Gjithsej fond pyjor e kullosor**	**Nga këto**			
			Pyje gjithsej	**Prodhues**	**Mbrojtës**	**Kullota gjithsej**
Berat	Berat	7568,0	7568,0	7568,0	0,0	0,0
Berat	Skrapar	2879,0	2879,0	2879,0	0,0	0,0
Berat	Total	10447,0	10447,0	10447,0	0,0	0,0
Elbasan	Elbasan	6195,7	6195,7	6195,7	0,0	0,0
Elbasan	Peqin	268,5	268,5	268,5	0,0	0,0
Elbasan	Total	6464,2	6464,2	6464,2	0,0	0,0
Fier	Fier	1472,0	1472,0	1472,0	0,0	0,0
Fier	Mallakastër	1586,6	1586,6	1268,6	318,0	0,0
Fier	Total	3058,6	3058,6	2740,6	318,0	0,0
Gjirokastër	Gjirokastër	9575,0	9575,0	9575,0	0,0	0,0
Gjirokastër	Përmet	3357,0	3357,0	3357,0	0,0	0,0
Gjirokastër	Total	12932,0	12932,0	12932,0	0,0	0,0
Kukës	Kukës	9502,0	9502,0	6502,0	3000,0	0,0
Kukës	Tropojë	19000,0	19000,0	11500,0	7500,0	0,0

Kukës	Total	28502,0	28502,0	18002,0	10500,0	0,0
Shkodër	Pukë	1720,0	1720,0	1720,0	0,0	0,0
Shkodër	Total	1720,0	1720,0	1720,0	0,0	0,0
Tiranë	Tiranë	2298,0	2298,0	2298,0	0,0	0,0
Tiranë	Total	2298,0	2298,0	2298,0	0,0	0,0
Vlorë	Delvinë	4564,0	2282,0	2282,0	0,0	2282,0
Vlorë	Sarandë	1713,5	1713,5	0,0	1713,5	0,0
Vlorë	Total	6277,5	3995,5	2282,0	1713,5	2282,0
TOTALI		71699,3	69417,3	56885,8	12531,5	2282,0